



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 01-060/01-39475

Pejë, datë: 17 Qershor 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i V-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **17 Qershor 2026**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend dite.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

Rendi i Ditës

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 15.05.2026.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.
6. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Në takim munguan z.Arben Morina dhe znj. Edonjeta Berisha.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 15.05.2026.

Procesverbali i datës 15.05.2026 shtyhet për miratim në seancën tjetër edhe pse ka qenë në material.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë ka ardh me rekomandim nga drejtoria për buxhet dhe financa, një pjesë e materialit ka ardh ndërsa pas degjimeve buxhetore kompletohet materiali. Kishte me qenë mirë që gjithë anëtarët e kuvendit me qenë prezent .

Nga të gjithë anëtarët prezent 3 votë pro, 4 nuk marrin pjesë, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është informatë që ka ardh nga drejtoria e zhvillimit ekonomik, nese ka dikush diqka e hapim diskutimin!

Z.Bekim Morina: pasi që drejtori nuk është prezent dhe materialin e kemi marr me vonese po propozoj ta kalojmë këtë pikë pa diskutim, dhe në seancë diskutojmë me drejtorin qka kemi pyetje dhe sqarime tjera.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë e kam një diskutim po mendoj që fluksi i turistëve që kanë ardh në Komunën e Pejës është shumë më i vogël, për shkak të infrastrukturës në Rugovë dhe vendimi i ministrisë që ka ndiku me pasoja të mëdha në biznese. Duke e ditur që një pjesë e madhe e turistave e frekuentojnë Rugovën.

Z.Naim Bytyqi: ky raport është skandaloz dhe shumica e të dhënave janë marrë nga statistikën e Kosovës. Dhe ato që i thekxhin kryesusi ky si ka pa si problematika hiq, veç i ka copy prej kompjuterit dhe i ka qit në raport. Sa i përket turizmit baza kryesore që ka ndiku është edhe rruga në Rugovë por janë edhe ndikimet të tjerë. Mirëpo turistat tjerë janë ardh edhe për qëllime tjera. Duhet me pas një gjendje pak më saktë dhe qka kërkon ky prej komunes me ndryshu dhe me u rrit turizmi në Komunën e Pejës, kurgjo hiq të dhëna të kompjuterit s'kom diskutim për këtë pikë!

Z.Ardit Berisha: në këtë raport nuk po e shoh që ka bo krahasime për vitin e kaluar dhe kishte me qenë mirë së paku 3 vitet e fundit me bo krahasime, dhe ne me pas pak më të qartë se qysh po shkon trendi i zhvillimit të sektorit të turizmit në Komunën e Pejës. Sa i përket konstatimit që e bëre sidomos për vendimin e qeverisë, unë mendoj që kjo nuk qëndron sepse nuk mundet vendimi për një muaj me ndiku për raportin e komplet të vitit. Vendimi është i bazuar në ligj dhe ligji e thotë qartë nuk bën me ndërtu në Rugovë. Dhe ministria vendimi që e ka marr është me ju rikujtu banorëve atje që nuk bën me ndërtu pa leje. Puna që na takon si komunë dhe juve si kryesusi me shty përpara është që me u bo planifikimi zhvillimor sepse ne nuk e kemi një plan si mu zhvillu ajo pjesë! Normalisht edhe ne jemi të interesuar me kontribi edhe ministria është e interesuar që ai plan me përfundu sa më shpejt dhe me u ndërtu aty sipas ligjit dhe rregullave ligjore. Ndërsa sa i përket rruges që është prish i ka fajet edhe komuna edhe duhet me pranë, sepse ka ndërtu atje rrugica sidomos në këto dy mandatet e fundit. Si pasoj që janë ndërtu ato rrugica mendoj që rruga kryesore është dëmtu. Sepse nuk ka qenë siç është tash por për shkak që janë ndërtu ato rrugica dhe mirë që janë bo, por edhe komuna duhet me pas nifar bashkë përgjegjësie në këtë punë. Se është kollaj me gjujt topin tek ministria, mirëpo është mirë me pranë që edhe na duke u mundu me bo mirë atje e kemi dëmtu rrugën kryesore! Por po besoj shumë që vullneti i ministrisë shpejt aty vetëm se është në proces aty të fillimit të fleksibilitetit dhe shumë shpejt ka me fillu me u rregullu komplet rruga aty! Jemi të interesuar si opozitë që Peja me pas sa më shumë turistë, sespe sa më shumë turista i shton të hyrat e komunës dhe ato mjete shpërndahen tek qytetarët, si në kushte infrastrukture, arsim dhe digastere të tjera. Po ashtu po pajtohem me Naimi për raportin që nuk përmbajtësor dhe nuk na lejon me kuptu drejtë dhe qartë situatën.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese thush qe komuna e ka fajin nuk është qashtu se perderisa jeni ju në pushtet nuk është prek kurgjo në rrugë. Kompania kontraten për mirëmbajtje e rruges e ka e nuk është dal kurrë në teren.

Z.Ardit Berisha: edhe ju kontaktoni policinë për shumë rrugë e kom thirr edhe vet sepse ata e kanë për detyrë me dal në terren dhe policia edhe ka shqiptu gjobë, sepse kompania e ka për detyrë mirëmbajtjen e rruges e kanë kontraten.

Z.Naim Bytyqi: njhere e mirë duhet me u mësu me bo një raport qka kanë punu gjatë dites me shkru në raport, jo me shkru prej kompjuterit. Punën të cilen e ka kry gjatë dites, mujit dhe gjatë vitit qajo qitet në raport.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 3 votë pro, 2 votë të përmbajtur, dhe 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr për këtë pikë, e hapim diskutimin.

Znj.Valbona Taraku Gjakova: në këtë raport këtu ka tregu vetem për diskutimet qka janë bo gjatë takimit, mirëpo nuk e kanë paraqit një pasqyrë reale të gjendjes së komunës tonë. Këtu kanë sqaru qysh institucionet kanë bashkëpunim, arsimi po shkon shumë mirë por nuk kemi të dhëna konkrete nuk kemi statistika dhe nuk mundet me qenë raport. Qytetarët duhet me pas të qartë me statistika dmth sa raste penale janë paraqit gjatë vitit duke e krahasuar me vitin e kaluar, sa incidente kanë ndodh, cilat pjesë të komunës kanë probleme me siguri. Po ashtu u përmenden sfidat e QKMF-së dhe shkollave por nuk po tregojnë cilat janë ato sfida. Gjithashtu në fund po thuhet se anëtarët e këshillit kanë jep rekomandime, mirëpo nuk po tregojnë cilat janë ato rekomandime. Për mendimin tim nuk është një raport i kompletum as ky e as të tjeret deri tash!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Fatmiri është jasht vendit dhe nuk ka mujt me qenë prezent. Sa i perket këshillit të KKSB-së është i përbër prej shumë akterve dhe si grup mendoj që është si preventiv për parandalim dhe nuk e di sa munden ata me jep detaje ma konkrete.

Z.Bekim Morina: KKSB-ja luan një rol të rëndësishëm dhe po e jepi si informatë se me ka ra me shku shumë here. Komandanti i policisë është anëtar i përhershem çdohere dhe në secilen mbledhje ai raporton. Ky këshill i mban 6 takime në vitë e kanë një plan të punës dhe ku parashohin secili digaster si arsimi, emergjenca, policia dhe anëtarët tjerë që janë prezent me i raportu informatat për secilin digaster por në raport të gjitha nuk munden me i përfshi. Por është takim i hapur dhe munden me marr pjesë kush don me bo pyetje dhe anëtarët i kanë informatat dhe munden me ju përgjigjë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë po mendoj që kishte me qenë mirë edhe ne si grup i KPF-së me marr pjesë në takim me KKSB-në. Takimet që i mban KKSB-ja qëllimin e ka me analizu situaten dhe menihere burojnë masat për parandalimin e problemeve të ndryshme.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 3 votë pro, 2 votë të përmbajtur, dhe 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

Z.Labinot Panxha: deshta me paraqit një kërkesë nga banorët e fsh.Buqan për ndërtimin e një pende. Banorët atje përballen mungësë të ujitjes të tokava bujqësore dhe me këtë pend të quajtur penda e mullirit ujiten 25h tokë në fsh. Buqan. Ata kërkuan që të parashihet në kornizen afatmesme buxhetore edhe ndërtimi i kesaj pende.

Z.Ardit Berisha: unë e kam kërkesen të cilen e kam adresu në seancën e kuvendit lidhur me subvencionimin e bujqve për produktet e qumshtit. Heren e fundit nuk hyri si pikë e rendit dites u shty si pikë dhe kërkoj që mbledhjen e ardhshme të hyjë si pike e diskutimit lidhur me problematikat e fermerve të cilet janë duke u përballur me sfida të mëdha. Po ashtu po mendoj që me i ndihmu bujqit me i përfshi në kornizen afatmesme buxhetore. Unë e kam bërë një propozim me 0.10 cent për litra e qumshtit, por te shohim tash cila është mundësia buxhetore e komunës, dhe të ju dalim ndihmë qoftë përkohësishtë deri sa të kalon kjo periudhë e vështirë e bujqëve. Edhe pse ministria i ka marrë disa masa lidhur me importin e qumshtit dhe i ka vendos disa masa atje për qumshtin pluhur dhe vajin e palmes, por hala po kanë probleme bujqit. Por shpresoj që kësaj radhe në kuvend do të diskutohet propozimi për mbështetje të bujqëve. Po ashtu edhe një çështje tjetër është nënshkru një memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Pejës dhe disa organizata OJQ-ve. Ndërkohë është një marvesheshje me Qendren e Mbrojtjes së Grave në mes të kryetarit dhe drejtoreshes së kesaj qendre e cila është antare e bordit në Eko-sig. Kjo mundet me qenë edhe konfliktë interesit dhe kërkoj sqarim nga ana e ekzekutivit se a e sheh si konflikt interesi nese mbështetet një OJQ e cila drejtoresha e saj po ashtu edhe antare në bordin e Ekosig-it. Problematik tjetër është në fsh. Kotrodiq aty është mirë mu parapa ndërtim i një ure, sepse atyre banorëve ju bjen komplet rrotullë me shku te tokat e tyre dhe mendoj që është e nevojshme ndërtimi i ures.

Pjesë e këtij procesverballi është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:20 h.

**Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina**



